

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR
"GES" SH.P.K.**

Përmbajtja:

KAPITULLI I THEMELIMI, EMËRTIMI, OBJEKTIVI, SELIA, KOHËZGJATJA	1
Neni 1 - Data e themelimi dhe themeluesi	1
Neni 2 - Forma	1
Neni 3 - Emërtimi	1
Neni 4 - Objekti i Shoqërisë	1
Neni 5 - Selia	4
Neni 6 - Kohëzgjatja e veprimtarisë	4
KAPITULLI II KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA E KUOTAVE TE	
KAPITALIT	5
Neni 7 - Kapitali themeltar	5
Neni 8 - Kontributet dhe kuotat	5
Neni 9 - Rritja a kapitalit themeltar '	5
Neni 10 - Zvogëlimi i kapitalit themeltar	5
Neni 11 - Transferimi i kuotave të kapitalit	5
KAPITULLI III ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME, ADMINISTRATORËT DHE EKSPERTI	
KONTABËL	6
Neni 12 - Asambleja e përgjithshme	6
Neni 13 - Administrimi	6
Neni 14 - Eksperti kontabël i autorizuar	7
KAPITULLI IV VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE	7
Neni 15 - Viti financiar dhe bilanci vjetor	7
Neni 16 - Fitimet	7
KAPITULLI V KAPITULLI V SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË	7
Neni 17 - Shpërndarja	7
Neni 18 - Likuidimi	7
Neni 19 - Gjuha	8
Neni 20 - Dispozita përfundimtare	8

KAPITULLI I THEMELIMI, EMËRTIMI, OBJEKTIVI, SELIA, KOHËZGJATJA

Neni 1 - Data e themelimi dhe themeluesi

- 1.1 Sot, më 1 maj 2024, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me ermin "GES sh.p.k."
- 1.2 Themeluesit e shoqërisë janë:
Ervin Spirollari, shtetas shqiptar, lindur më 26 dhjetor 1981 në Pogradec dhe banues në Tiranë, Shqipëri, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar sipas ligjit me nr. personal I11226047B.

Neni 2 - Forma

- 2.1 Shoqëria "GES sh.p.k." (në vijim "Shoqëria") themelohet si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me ortak të vetëm dhe funksionon sipas këtij Statuti dhe Akti Themelimi.
- 2.2 Shoqëria do të funksionojë sipas legjislacionit shqiptar.

Neni 3 - Emërtimi

- 3.1 Emërtimi i Shoqërisë është "GES" sh.p.k., ndjekur në mënyrë të pandashme nga shkurtimi "sh.p.k.", i cili përfaqëson dhe formën e saj ligjore.

Neni 4 - Objekti i Shoqërisë

- 4.1 Shoqëria ushtron aktivitet tregtar në fushën e shëndetësisë, dermo-kozmetikës, fizioterapisë, produkteve farmaceutikë dhe parafarmaceutikë, integrorëve ushqimorë dietetikë dhe sportive, artikuj sanitarë, makineri, pajisje si dhe aksesore që i shërbejnë këtij qëllimi në përputhje me autorizimet dhe akreditimet publike të parashikuara nga legjislacioni shqiptar, në fushën e pasurive të paluajtshme, marketingut, konsulencave, turizmit mjekësor etj., si më poshtë vijojnë, por pa u kufizuar vetëm në to:
 - Import- eksport dhe tregtim me shumicë dhe/ose me pakicë të produkteve mjekësore, dentare apo farmaceutike, ushqimore, industriale, reagentëve dhe kiteve, produkteve kozmetike, etj;
 - Import- eksport dhe tregtim i pajisjeve, aparaturave të ndryshme mjekësore, dentare dhe/ose shëndetësore si dhe organizim dhe kryerje shërbimi të instalimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve shëndetësore, etj;
 - Import- eksport dhe tregtim me shumicë dhe/ose pakicë i kremrave, vajrave dhe produkteve të ndryshme për fytyrën dhe trupin, aktivitete të trajtimeve të ndryshme estetike, dermo-kozmetikës, fizioterapisë për fytyrën, trupin e flokun në përgjithësi, i pajisjeve për mirëqenien e trupit dhe bukurisë në përgjithësi, dhe çdo lloj produkti tjetër të nevojshëm;
 - Import eksport dhe tregtim të pajisjeve mjekësore dhe dentare të implantueshme;
 - Import eksport dhe tregtim të veshjeve, pajisjeve dhe veglave sportive;

Neni 4 - Objekti i Shoqërisë (vazhdim)

- Import- eksport, tregtim, projektimi dhe prodhimi i produkteve dhe pajisjeve dentare e mjekësore për implantet dentare, pajisjeve mjekësore për implantet dentare, të specialiteteve farmaceutike, produkteve kirurgjikale, produkteve galenike dhe produkteve të tjera teknike për mjekë stomatologe dhe spitale publike apo private;
- Import- eksport, tregtim, projektimi dhe prodhimi i produkteve dhe pajisjeve për dezinfektim, dezinfektim, deratezim, deodorizim , etj;
- Ekspertizë dhe aktivitet në fushën e zhvillimit rregullator dhe marketimit për barnat që përdoren në njerëz, për pajisjet mjekësore, për suplementet ushqimore, fitopreparatet, produkte e higjienës dhe produktet dermokozmetike, materiale që përdoren në stomatologji, pajisjet mjekësore e aksesorë të tyre dhe pajisje diagnostikues dhe laboratorike në shëndetësi;
- Aktivitete në fushën e fizioterapisë, kryerja e vizitave mjekësore, kujdesit në shtëpi për çdo moshë;
- Blerje, shitje, prodhim dhe riparim të komponentëve, pajisjeve, aparateve dhe produkteve ortopedike që përfshijnë, por pa u kufizuar në: këpucë ortopedike, shtrroje ortopedike, proteza, orteza, korse, suporte dhe splinte; shërbime, vizita dhe konsulta të përgjithshme e të detajuara ortopedike; vizita, konsulta, ndërhyrje dhe përkujdesje mjekësore të kujdesit parësor; vizita, konsulta, ndërhyrje dhe kujdes inferior; vizita, konsulta, ushtrime dhe shërbime fizioterapie;
- Furnizimin dhe ofrimin e shërbimeve laboratorike, dentare, klinike, biokimike, mikrobiologjike, gjenetike etj;
- Formim, strukturim dhe manaxhim të strukturave mjekësore, ngritja e qendrave të ndryshme laboratorike dhe/ose ekzaminuese, qendrave estetike, klinikave, spitaleve, klinike dentare dhe laborator dentar, grafisë dentare etj;
- Grumbullim, përpunim dhe tregtim i bimëve mjekësore e industriale;
- Shitjen online (e-commerce/tregti elektronike) të produkteve të sipërpërmendura etj;
- Prodhimi në vend potencialisht i çdo produkti të përfshirë në kategoritë e sipërpërmendura, ngritja e linjave e të pajisjeve të prodhimit, ngritja dhe vënia në funksionim e impiantëve tekniko-industrialë dhe e ndërmarrjeve të posaçme, parqeve e konsorciumeve teknike e teknologjike të lidhur me qëllimin e mësipërm;
- Veprimtari plotësuese për aktivitetet e mësipërme si për shembull: shërbime restoranti, shërbime farmaceutike, shërbime të pastrimit, mbledhjes dhe transformimit të mbetjeve, krijimi, funksionimi apo manaxhim i shoqërive të udhëtimit, të turizmit në përgjithësi dhe të transportit aktiviteti i të cilave është i lidhur me objektet e Shoqërisë etj;
- Ndërtimi dhe vënia në funksionim, marrje me qira, gëzimin, manaxhimin, dhënien me qira, nënqira, hua dhe administrimin e pasurive të paluajtshme të çdo natyre dhe lloji si: fermave, qendrave të agroturizmit, qendrave termale, resorteve, hoteleve, SPA, palestrave, qendrave fitness e sportive në përgjithësi, restoranteve dhe aktiviteteteve komerciale të këtij lloji, organizimi i aktiviteteteve të lidhur me këto fusha e në shërbim të jetës, shëndetit e mirë qënies së njeriut;
- Turizëm mjekësor e dentar, ofrimin e të gjitha shërbimeve mjekësore e dentare pacientëve të huaj duke përfshirë edhe udhëtimin, akomodimin, guidën turistike, etj. Zhvillimi, krijimi dhe tregtimi i paketave turistike për këtë qëllim. Për kryerjen e aktivitetit të mësipërme, për të cilin do të nevojitet lejë përkatëse, Shoqëria është e detyruar të pajiset paraprakisht me këtë lejë nga organi kompetent;

Neni 4 - Objekti i Shoqërisë (vazhdim)

- Ndërtimi, vënien në funksion apo manaxhimin e strukturave të hotelerisë dhe ofrimin e shërbimeve të hotelerisë, përfshirë edhe çdo veprimtari tjetër plotësuese që lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me veprimtarinë e manaxhimit të strukturave të hotelerisë dhe ofrimit të shërbimeve të hotelerisë;
- Realizimin e punimeve të ndërtimit të çdo lloji dhe natyre duke përfshirë përmirësimin e pasurive të paluajtshme të marra me qira, ndërtimin apo ristrukturimin e pasurive të paluajtshme, si dhe blerjen, shitjen, shkëmbimin e pasurive të paluajtshme të çdo lloji dhe natyre;
- Planifikim dhe realizim i fushatave të ndryshme publicitare dhe promovuese në kuadër të turizmit shëndetësor, dentar, etj;
- Publikim, promovim dhe marketim të produkteve farmaceutike, pajisjeve mjekësore, suplementeve ushqimore dhe kozmetike, prodhime audio – vizuale, krijim dhe realizim spotesh publicitare, video klipe, organizim panairësh dhe workshop-esh, shërbime audio, ndriçim, montazh, prodhim televiziv, ngritja dhe funksionimi i shtëpive botuese, stacioneve radiotelevizivë, qendrave dhe rrjeteve Data dhe rrjeteve të informimit social të lidhur me objektin e Shoqërisë dhe sipas legjislacionit në fuqi etj;
- Ndërtimi, vënia në funksionim, administrimi apo pjesmarrja në ndërmarrje të lidhura me ekologjinë dhe mjedisin, ndërtimi dhe vënia në funksionim të impianteve të përpunimit të mbeturinave, riciklimit të tyre, rigjenerimit të lëndëve apo pajisjeve që kontribuojnë në ekonomi e mjedis, në të gjitha aktivitetet e këtij lloji, sipas normave dhe standarteve më të mirë dhe legjislacionit në fuqi;
- Krijimi, funksionimi dhe pjesmarrja në shoqëri sigurimesh, shoqëri financiare, banka apo agjenci të sektorit ekonomik-financiar aktiviteti i të cilave është i lidhur në mënyrë të drejtpë apo të tërthortë me objektin e Shoqërisë;
- Konsulencë financiare, juridike, tekniko-shkencore dhe dhënie-marrje e know -how në të gjitha fushat e përfshira në objektin e Shoqërisë. Veprimtari konsulente dhe ndërmjetësimit në fushat e mësipërme;
- Manaxhim dhe/ose ndërtim i strukturave për formimin e mjekëve dhe paramjekëve, krijimi dhe organizimi i kurseve të trajnimit dhe kualifikimit arsimor e profesional për të gjitha nivelet për trajtimin e mjekëve dhe paramjekëve, organizimi dhe mbajtja e kualifikime shkencore pasuniversitare, kurse të specializimit dhe të kualifikimit afatshkurtër e afatgjatë etj;
- Organizimi dhe kryerja e studimeve, kërkimeve dhe botimeve, grumbullimin dhe përpunimin e informacioneve apo shpërndarjen e njoftime të ndryshme si njoftime pune, njoftime shit-bletje, qiradhënie pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme.etj;
- Krijimi dhe vënia në funksionim i qendrave apo njësive të projektimit e të administrimit të softwhere-ve apo të Data Base në funksion të qëllimeve të Shoqërisë apo në funksion të palëve të treta të interesuara, sipas legjislacionit në fuqi, tregtimi dhe reklamimi i produkteve të gatshëm në këtë fushë, etj;
- Pjesëmarrja në projekte e studime që kanë për objekt fushat e veprimtarisë së Shoqërisë;
- Aktivitete Trusty & Management për llogari të Shoqërisë apo të palëve të treta në të gjitha këto fusha;
- Krijimi i organizatave dhe i shoqërive joqeveritare të karakterit non for profit, social, kulturor, tekniko-shkencor, i fondacioneve, konsorciumeve apo pjesmarrja në to;

Neni 4 - Objekti i Shoqërisë (vazhdim)

- Pjesmarrja dhe kontributi në të gjitha nismat kulturore e sociale në shërbim të komunitetit, të drejtave të njeriut, barazisë gjinore etj, sipas standarteve më të mirë. Promovimi i vlerave sociale, aktivitete bamirësie etj.

Në funksion të qëllimeve të mësipërme Shoqëria mund të hyjë në tregje dhe operacione të ndryshme, të zotërojë pasuri të luajtshme e të paluajtshme, të realizojë në mënyrë drejtpërdrejtë apo të tërthortë çdo lloj pjesëmarrje në shoqëri të tjera shiptare apo të huaja, si edhe të hyjë në marrëdhënie kontraktore, bashkëpunimi ose ortakërie me persona të tretë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj. Shoqëria gjithashtu mund të realizojë bashkëpunime me shoqëri të tjera që kanë të njëjtin objektiv ose të ngjashëm me atë të Shoqërisë, si dhe në raste të veçanta në sektorë të tjerë, bashkëpunime me persona fizikë dhe çdo lloj tjetër bashkëpunimi sipas legjislacionit në fuqi. Shoqëria mund të veprojë si agjent/ndërmjetës për kryerjen e aktiviteteve të mësipërme dhe bazuar në diskrecionin e saj, mund të kontraktojë palë të treta për kryerjen e një pjese apo të të gjitha aktiviteteve të mësipërme. Në përgjithësi, Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari tjetër që, edhe pse nuk ka lidhje me sa është parashikuar më sipër, nuk përbën një veprimtari të ndaluar me ligj dhe është në funksion të përmbushjes së objektit të Shoqërisë.

Neni 5 - Selia

- 5.1 Selia e Shoqërisë është në Tiranë, në adresën “Rruga e Barrikadave”, Kulla 8, Kati II, ZK. 8370, Pasuria nr. 10/139+1-4, Tiranë, Shqipëri.
- 5.2 Transferimi i selisë së Shoqërisë në një vend tjetër bëhet me vendimin e Ortakut të vetëm.
- 5.3 Ortaku i vetëm mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë si edhe jashtë saj.

Neni 6 - Kohëzgjatja e veprimtarisë

- 6.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është me afat të pacaktuar, duke filluar që nga data e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

KAPITULLI II KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA E KUOTAVE TE KAPITALIT

Neni 7 - Kapitali themeltar

- 7.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100 (njëqind) Lekë.
- 7.2 Kapitali themeltar i Shoqërisë përbëhet nga 1(një) kuotë, me një vlerë prej 100 (njëqind) Lekësh.

Neni 8 - Kontributet dhe kuotat

- 8.1 Kapitali i Shoqërisë është i barabartë me 100 (njëqind) Lekë, përbehet nga 1 (një) kuotë, dhe zotërohet nga Ortaku i vetëm si më poshtë:

Ervin Spirollari, shtetas shqiptar, lindur me 26 dhjetor 1981 në Pogradec dhe banues në Tiranë, Shqipëri, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me nr. personal I11226047B është zoterues i të gjithë kapitalit të Shoqërisë GES sh.p.k.
- 8.2 Sipas kontributeve të mësipërme: Ortaku i vetëm, Ervin Spirollari, zotëron 100% të kapitalit themeltar të Shoqërisë.
- 8.3 Kontributet në para do të paguhen (plotësisht) menjëherë. Kontributet në natyrë do ti kalojnë Shoqërisë pas regjistrimit në QKB.
- 8.4 Pagesa e kontributeve në para do të kryhet në llogarinë e Shoqërisë menjëherë pas regjistrimit në QKB.

Neni 9 - Rritja a kapitalit themeltar'

- 9.1 Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, me vendim të Ortakut të vetëm.
- 9.2 Në rast rritjeje të kapitalit, kuota e ortakut do të rritet sipas shumave të përcaktuara në vendimin për rritjen e kapitalit.

Neni 10 - Zvogëlimi i kapitalit themeltar

- 10.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimin e Ortakut të Vetëm. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
- 10.2 Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga ortaku sipas shumave të përcaktuara në vendimin për zvogëlimin e kapitalit.

Neni 11 - Transferimi i kuotave të kapitalit

- 11.1 Kuotat e kapitalit janë lirish të transferueshme sipas nenit 73 të Ligjit 9901, i datës 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar

KAPITULLI III

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME, ADMINISTRATORËT DHE EKSPERTI KONTABËL

Neni 12 - Asambleja e përgjithshme

- 12.1 Asambleja e Përgjithshme është organi vendimmarrës i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme vendos mbi të gjitha çështjet për të cilat është kompetente sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë, sipas këtij Akt Themelimi dhe Statuti dhe/ose çdo marrëveshje midis ortakëve të Shoqërisë .
- 12.2 Duke qenë se Shoqëria GES sh.p.k. është një shoqëri me ortak të vetëm, në përputhje me ligjin për shoqëritë tregtare, të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme do të ushtrohen nga Ortaku i vetëm.
- 12.3 Ortaku ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër, i pajisur me prokurë me shkrim, me anën e së cilës mund të japë votën e tij.
- 12.4 Ortaku i vetëm mund të thirret në çdo moment nga Administratori. Në çdo rast, Ortaku i vetëm duhet të marrë vendim së paku një herë në vit për të shqyrtuar dhe miratuar bilancin e periudhës ushtrimore financiare të mëparshme.
- 12.5 Ortaku i vetëm, nesë thirret nga Administratori, duhet të thirret nëpërmjet njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigje e cila duhet t'i dërgohet atij, në adresën që rezultojnë dokumentet e Shoqërisë, të paktën 7 (shtatë) ditë përpara mbledhjes. Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi çështjet që do të trajtohen dhe për të cilat do të merret vendim, vendin, datën dhe orën e mbledhjes.
- 12.6 Ortaku i vetëm mund të marrë vendime edhe jashtë selisë së Shoqërisë, në Shqipëri apo në një vend to huaj.

Neni 13 - Administrimi

- 13.1 Shoqëria administrohet nga 1(një) Administrator, emëruar prej Ortakut të vetëm, i cili qëndron në detyrë deri në revokimin apo dorëheqjen e tij, apo për një periudhë prej 5 (pesë) vitesh. Ai mund të rizgjidhet për të njëjtin afat. Administrator mund të jetë votë Ortaku i vetëm,
- 13.2 Administrator caktohet Ervin Spirollari, shtetas shqiptar, lindur me 26 dhjetor 1981 në Pogradec dhe banues në Tiranë, Shqipëri, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me nr. personal I11226047B madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, emëruar prej Ortakut të Vetëm, i cili qëndron në detyrë deri në revokimin apo dorëheqjen e tij, apo për një periudhë prej 5 (pese) vitesh.
- 13.3 Përfaqësimi ligjor i Shoqërisë i takon Administratorit. Administratori do të kryejë të gjitha aktet e administrimit të zakonshem dhe të jashtëzakonshem të Shoqërisë, përjashtuar kompetencat të cilat i përkasin organeve të tjerë të Shoqërisë sipas ligjit të aplikueshëm apo sipas këtij statuti.
- 13.4 Administratori mund të emërojë përfaqësues të posaçëm për akte të veçanta ose për kategori aktesh.

Neni 14 - Eksperti kontabël i autorizuar

- 14.1 Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Ortaku i vetëm, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë do t'i besohet një eksperti kontabel të autorizuar.

KAPITULLI IV VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 15 - Viti financiar dhe bilanci vjetor

- 15.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit.

Neni 16 - Fitimet

- 16.1 Fitimet neto që rezultojnë nga bilanci vjetor, duke zbritur të gjitha shumat që Ortaku i vetem vendos t'i verë mënjanë, i shpërndahen Ortakut, ose me vendim të tij riinvestohen apo kapitalizohen brenda Shoqërisë.
- 16.2 Ortaku i vetëm mund të vendosë edhe zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo dhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.

KAPITULLI V KAPITULLI V SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Neni 17 - Shpërndarja

- 17.1 Shoqëria prishet në rastet e parashikuara nga ligji ose me anë të një vendimi të Ortakut të vetëm.
- 17.2 Shoqëria nuk prishet në rast të falimentimit të ortakut.

Neni 18 - Likuidimi

- 18.1 Në rast shpërndarje, shoqëria duhet të likuidohet.
- 18.2 Për të administruar këtë procedurë, Ortaku i vetëm emëron një ose me shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.
- 18.3 Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Ortaku i vetëm do të vendosë mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.
- 18.4 Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do t'i shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit ortakut.

Neni 19 - Gjuha

19.1 Ky statut është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

Neni 20 - Dispozita përfundimtare

20.1 Lidhur me çka nuk është parashikuar shprehimisht prej këtij statuti dhe akti themelimi do të zbatohet ligji shqiptar mbi shoqëritë tregtare.

20.2 Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të jetë kompetente Gjykata e Tiranës.

Ortaku i vetëm i Shoqërisë
Ervin Spirollari